REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

16 08

Maliq më 18.03.2026

Projekt-Vendim - NR. 5

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

I. Miratim fondi për familjet e mëposhtëme:

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	**Neki Shkëmbasi**	F70101035M	Libonik	300 000
2	**Arefi Bazelli**	D90918061G	Vreshtas	20 000
3	**Lavdije Mata**	H06010027B	Vreshtas	20 000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2026, si më poshtë :

Gr.	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	010430	606	Fondi Social	340 000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Konceptoi Pergj.Sek i Politikave Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petriti

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topciu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

1608

Maliq më 18.03.2026

Relacion

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

1.Neki Shkëmbasi

Z. Neki Shkëmbasi është banor i fshatit Shkozë, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq. Ai jeton së bashku me bashkëshorten, djalin dhe dy mbesat e mitura, për shkak se djali është i divorcuar.Familja Shkëmbasi ndodhet në kushte të vështira ekonomike. Të ardhurat e vetme siguroheshin nga aktiviteti blegtoral i familjes. Sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, më datë 24.06.2025, ferma e familjes është prekur nga sëmundja "Murtaja e Ruminantëve të Vegjël", si pasojë e së cilës janë asgjësuar (groposur) 211 krerë bagëti të imëta. Kjo situatë ka sjellë humbjen e plotë të burimit të vetëm të të ardhurave për familjen. Duke qenë se banesa ndodhet në zonë rurale, larg qendrës urbane dhe me mundësi të kufizuara punësimi, familja aktualisht ndodhet pa të ardhura dhe në pamundësi për të përballuar nevojat bazë të jetesës. Në këto kushte, i propozojmë Këshillit Bashkiak Maliq miratimin e një ndihme financiare për përballimin e situatës emergjente ekonomike të kësaj familjeje.

2.Arefi Bazelli

Z. Arefi Bazelli është banor i fshatit Vreshtas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq. Ai jeton së bashku me bashkëshorten e tij; të dy janë pensionistë. Para disa kohësh, z. Arefi ka pësuar ishemi cerebrale dhe, si pasojë, ka mbetur i paralizuar. Për shkak të gjendjes shëndetësore, ai ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme, mjekim të përditshëm dhe kontrolle periodike në Tiranë.Burimi i vetëm i të ardhurave për familjen është pensioni minimal i z. Arefi dhe i bashkëshortes së tij i propozojmë Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare për përballimin e shpenzimeve.

3. Lavdije Mata

Znj. Lavdije Mata është banore në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq. Familja e saj përbëhet nga katër anëtarë: znj. Lavdije dhe tre fëmijët e saj, dy vajza dhe një djalë, pasi bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë.Kjo familje klasifikohet si familje në nevojë, duke u përballur me vështirësi të theksuara ekonomike dhe sociale. Znj. Lavdije Mata është e papunë dhe nuk disponon të ardhura të qëndrueshme, ndërsa të ardhurat e familjes përbëhen kryesisht nga ndihma ekonomike, e cila është e pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë të jetesës.Gjithashtu, znj. Lavdije paraqet probleme shëndetësore, të cilat e vështirësojnë më tej mundësinë e saj për t'u punësuar dhe për të siguruar të ardhura për familjen. Ndërkohë, djali i saj është në moshë të mitur dhe ndjek arsimin, çka shton më tej vështirësitë ekonomike të familjes për përballimin e shpenzimeve të përditshme. Si pasojë, familja ndodhet në kushte të vështira jetese dhe ka nevojë për mbështetje të menjëhershme. Në këto kushte, propozojmë pranë Këshillit Bashkiak Maliq miratimin e një ndihme financiare për këtë familje, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe përballimin e vështirësive ekonomike.

Konceptoi Pergj.Sek i Politikave Sociale
Miratoi: Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petriti

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ